



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 920/ prot.
2

Tiranë më 4.6.2018

Lënda: Për kërkesën e paraqitur nga znj. Albana Vokshi.

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM

KUVENDI I SHQIPËRISË

Tiranë


*Znj. Albana Vokshi
Deputete.
Për detyrimin tuaj
05.06.18*

Bashkëlidhur do të gjeni përgjigjen në lidhje me shkresën e deputetes së Kuvendit të Shqipërisë, znj. Albana Vokshi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 920 / prot.
1

Tiranë më 4 . 6 . 2018

Lënda: Përgjigje për kërkesën tuaj.

Znj. Albana VOKSHI

DEPUTETE, KUVENDI I SHQIPËRISË

Tiranë

E nderuar Znj. Vokshi,

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u njoh me shkresën tuaj nr. 1768 prot, datë 22.05.2018, administruar pranë nesh me nr. 920 prot, datë 23.05.2018.

Zyra e Komisionerit me Urdhërin nr. 138, datë 07.05.2018 realizoi hetimin administrativ pranë kontrolluesit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me objekt:

- ✓ Verifikimi i ligshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe sensitive, gjatë procesit të mbledhjes dhe përditësimit të databazës së pacientëve që marrin shërbim shëndetësor në qendrat shëndetësore, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Në këtë kuadër u konstatua se kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale po zbaton projektin “Për ndërtimin e databazës së të dhënave me qëllim informimin e pacientëve për çështje që kanë të bëjnë me të rejat në fushën e shëndetësisë, shërbimet e reja që do të ofrojë sistemi shëndetësor, promocionin shëndetësor dhe për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore në institucionet publike, organizim më efektiv të punës, rritjen e ndërveprimit”, nëpërmjet të cilit synon:

- ✓ Komunikimin me pacientët, informimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me të rejat në fushën e shëndetësisë, për shërbimet e reja që do të ofrojë sistemi shëndetësor, për promocionin shëndetësor dhe për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore në institucionet publike;
- ✓ Krijimin e bazës së të dhënave të punëmarrësve për të bërë të mundur një organizim më efektiv të punës, rritjen e ndërveprimit, me synim arritjen e rezultateve më të larta në shëndetësi.

Për realizimin e këtij projekti, MSHMS ka hartuar dy formularë për mbledhjen e të dhënave për kategorinë e subjekteve të të dhënave “Pacientë” dhe një formular mbledhjen e të dhënave për kategorinë e subjekteve të të dhënave “Punëmarrës”.

Zyra e Komisionerit konstatoi se deri në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ, kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pavarësisht se kishte shpërndarë formularët, nuk kishte filluar me mbledhjen e të dhënave.


Në këtë kushte, në përfundim të hetimit administrativ dhe rezultateve të tij Zyra e Komisionerit doli me rekomandim ndaj këtij kontrolluesi, të cilin ju mund ta gjeni bashkëlidhur si dhe në faqen tonë online www.idp.al.

Në përputhje me dispozitat ligjore, një ndër pikat e rekomandimit është që kontrolluesi brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh të kryej plotësimin e detyrimeve të parashikuara në këtë rekomandim dhe të njoftoj Zyrën e Komisionerit.

Duke ju falenderuar për kontributin tuaj,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 837 / prot.
3

Tiranë më 31.5.2018

REKOMANDIM

Nr. 21, datë 31.5.2018

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 138, datë 07.05.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), me objekt kontrolli:

- Verifikimi i ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe sensitive, gjatë procesit të mbledhjes dhe përditësimit të databazës së pacientëve që marrin shërbim shëndetësor në qendrat shëndetësore, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Hetimi pranë këtij kontrolluesi u inicua nga Zyra e Komisionerit bazuar në indiciet/ankesat, publikimet në median audio-vizive dhe atë të shkruar si dhe interesin publik që paraqet mbrojtja e të dhënave personale që përcupohet në kuadër të implementimit të projektit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për ndërtimin e databazës së të dhënave me qëllim informimin e pacientëve për çështje që kanë të bëjnë me të rejat në fushën e shëndetësisë, shërbimet e reja që do të ofrojnë sistemi shëndetësor, promocionin shëndetësor dhe për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore në institucionet publike, organizim më efektiv të punës, rritjen e ndërveprimit".

Kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nëpërmjet këtij projekti synon:

- Komunikimin me pacientët, informimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me të rejat në fushën e shëndetësisë, për shërbimet e reja që do të ofrojnë sistemi shëndetësor, për promocionin shëndetësor dhe për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore në institucionet publike;
- Krijimin e bazës së të dhënave të punëmarrësve për të bërë të mundur një organizim më efektiv të punës, rritjen e ndërveprimit, me synim arrijen e rezultateve më të larta në shëndetësi.

Për realizimin e këtij projekti, MSHMS ka hartuar dy formularë për mbledhjen e të dhënave për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Pacientë" dhe një formular mbledhjen e të dhënave për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Punëmarrës". si më poshtë vijon:

- Kategoritë e të dhënave që synohen të mbliidhen nga spitalet rajonale për kategoritë e subjekteve pacientë janë:
Numri personal i identifikimit, emër, mbiemër, numër celulari, e-mail, shërbimi (urgjencë, shtrim, ambulator/konsulti), spitali rajonal, data e shtrimit/marrjes së shërbimit dhe data e daljes;
- Kategoritë e të dhënave që synohen të mbliidhen nga qendrat shëndetësore për kategoritë e subjekteve pacientë janë:
Numri personal i identifikimit, emër, mbiemër, numër celulari, e-mail, qendra shëndetësore, DRSH, DSHP dhe data e vizitës;
- Kategoritë e të dhënave që synohen të mbliidhen për kategoritë e subjekteve punëmarrës janë:
Emër, mbiemër, datëlindja, numër telefoni, e-mail, pozicioni i punës, diploma, specialitetit (mjeke specialist) dhe data e fillimit të punës.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, lidhur me implementimin e projektit rezultoi se kontrolluesi MSHMS, gjatë procesit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për këtë qëllim të ri, nuk ka parashikuar respektimin e parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave personale, sanksionuar në nenin 5/1/c të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si p.sh lidhur me përpunimin e kategorive të të dhënave personale "Numër personal të identifikimit", për kategorinë e subjekteve të të dhënave pacientë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se sasia e të dhënave parashikuar për tu mbledhur nga kontrolluesi në kuadër të procesit të mbledhjes dhe përditësimit të të dhënave personale me qëllim final promocionin shëndetësor dhe vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore, është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave personale sanksionuar në nenin 5 pika 1/c e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. *Mbrojtja e të dhënave bazohet në*

mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

Gjatë hetimit administrativ në kontrolluesin MSUIMS, është konstatuar se projekti për mbledhjen dhe përditësimin e të dhënave personale të pacientëve për këtë qëllim të ri nuk mbështetet në një bazë ligjore specifike e cila të parashikoj këtë lloj përpunimi. Përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në mungesë të një parashikimi ligjor, kontrolluesi duhet të mbështetet në ekzistencën e pëlqimit si e vetmja mundësi ligjore, referuar nenit 6 pika 1/a të ligjit, për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale. Pëlqimi, në bazë të nenit 3 pika 24 të ligjit, "duhet të jetë në formën e një deklaratë me shkrim, i dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij".

Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi MSUIMS, nuk kishte parashikuar masa në drejtim të informimit të subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatën e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë dhe nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë si dhe me faktin nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare.

Në kuadër të zbatimit të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nga verifikimi i njoftimit të kontrolluesit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, rezultoi se nuk është përditësuar përmbajtja e tij lidhur me përpunimin e të dhënave personale të punëmarrësve dhe pacientëve për këtë qëllim të ri.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për të përditësuar njoftimin (para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat) nëpërmjet "Formularit të Njoftimit" është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji.

Rezultoi se deri në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ, kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pavarësisht se kishte shpërndarë formularët, nuk kishte filluar me mbledhjen dhe përditësimin e të dhënave personale për qëllimet e sipërcituara.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime, dhe parashtruan se janë dakort me përmbajtjen e procesverbalit.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ, i cili ka qenë i ndërsjellët në funksion të zbatimit të ligjit. Në vijim kontrolluesi është angazhuar në përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5/1/c, 6/1/a, 18, 21, 27, 29, 30 dhe 31/1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të nenit 5/1/c të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të zbatojë parimin e mjaftueshmërisë, duke mbledhur dhe përpunuar ato të dhëna që lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
2. Kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të nenit 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të zbatojë kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave, duke mbledhur dhe përpunuar të dhëna vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në këtë parashikim ligjor;
3. Kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të marrë masa në drejtim të informimit të subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë dhe nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare.
Në rubrikën mbi "Politikat e Privatësisë" të publikuar në faqen zyrtare në internet të Ministrisë, të përfshihen edhe elementet informues për këtë përpunim të ri, në referim të Opinionit të Zyrës së Komisionerit "Mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publik dhe privat" (publikuar në faqen zyrtare www.idp.al);
4. Kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të kryej përditësimin e gjendjes së njohimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë;

5. Kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të përfshijë në rregulloren e brendshme, mbi sigurinë e të dhënave personale, rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave për këtë qëllim të ri, për sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj;
6. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor nga momenti i marrjes djeni;
7. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjorbë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 31. 5.2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

